


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË
ZYRA NOTERIALE FIER
Nr. 1526 rep. Nr. 562 kol.



1

KONTRATË SHITJE E KUOTËS SË KAPITALEVE NË SHOQËRINË “INTEL MEDIA” Sh.p.k.

Në Fier, sot më datën 25 nëntor 2019, në Zyrën e Noterisë, përpara meje noteres Arjana Dodi, Anëtare e Dhomës së Noterëve Dega Vlorë, me Zyrë Noteriale në Fier lagje “Konferenca e Pezës”, me liçense numër 16 datë 07/08/1994 dhe NIPT K32721431M, u paraqitën personalisht :

PALA SHITËSE :

ERJON MARINI, atësia Pandeli, i datëlindjes 01/07/1976, lindur dhe banues në Fier, përfaqësuar me prokurë të posaçme prej **LEDION ARQILE ÇALA**, dl. 24/10/1982, lindur në Fier dhe banues në Fier, Lagje “Kastriot”, identifikuar me pasaportë numër personal I21024067A (prokura e posaçme nga Noteri në Gjermani datë 11.11.2019, e vërtetuar me vulë Apostille, përkthyer nga perkthyesi Olsian Kalaj dhe noterizuar nga nga zyre noterie, me numer 1518 rep datë 25/11/2019), i aftë për të kryer veprime juridike,

Këtu e më poshtë cilësuar “Shitësi” ose “Pala shitëse”,

PALA BLERËSE:

TEUTA MURATI, atësia Qemal, e datëlindjes 14/06/1965, lindur në Fier dhe banuese në Fier, Lagje “Kastriot”, identifikuar me letërnjoftimin ID numër personal G55614018T, e aftë për të kryer veprime juridike,

Këtu e më poshtë cilësuar “Blerësja” ose “Pala blerëse”,

BAZA LIGJORE:

1-Ligji 9901 datë 14-04-2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

2-Vendim datë 25/11/2019, i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Intel Media” shpk.

3-Ligji 110 datë 20/12/2018 “Për Noterinë”.

OBJEKTI I KONTRATËS:

1
Murati

Shitja e kuotave të kapitalit të shoqërisë “Intel Media” shpk në masën 34% nga ana e ortakut ERJON MARINI (përfaqësuar me prokurë prej LEDION ÇALA) dhe blerja e tyre nga blerësja TEUTA MURATI.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS:

Nga verifikimi i statusit ligjor të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit të Bizneseve, vërtetohet se shoqëria “INTEL MEDIA” shpk, me status aktiv, me qendër në Fier lagje “Apollonia”, rruga “Sheshi Fitorja”, prapa Foto Studio Rustemi, është rregjistruar në rregjistrin tregtar të shoqërive tregtare si person juridik, me numër NIPT **K82803409T**, me objekt veprimtarie : “*Veprimtari radiotelevizive*” me ortakë:

- 1- Rexhep Himo, me 33 % të kuotave të kapitalit,
- 2- Shan Sulejmani, me 33 % të kuotave të kapitalit,
- 3- Erjon Marini, me 34% të kuotave të kapitalit.

Kapitali thelemtar i kësaj shoqërie është 100 000.00 lekë (njëqindmijë) ose nga një kuotë (sipas parimit: Një anëtar – një kuotë) , në pronësi të secilit ortak.

Me këtë kontratë shitblerje, shitësi Erjon Marini, nëpërmjet përfaqësuesit të tij Ledion Çala, i shet blerëses Teuta Murati, kuotat e tij të kapitalit që i përkasin në këtë shoqëri, që përfaqësojnë 34% të kuotave të përgjithshme.

Për shitjen e kuotave të kapitalit në pronësi të Erjon MARINI, ka dhënë pëlqimin edhe bashkëshortja e tij, z.EDIOLA NIKOLLAQ MARINI, dl. 20/09/1983, lindur në Fier dhe banuese në Fier, sipas Deklaratës Noteriale me nr. 1520 rep dhe nr. 559 kol. datë 25/11/2019, të kësaj zyre noterie.

Shitja e kuotave të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie, në masën 34%, nga ana e ortakut ERJON MARINI, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë së tij mbi këto kuota si pasojë e këtij trasanksioni shitje.

Nga ana tjetër blerësja Teuta Murati, është plotësisht dakort që të blejë këto kuota në masën 34%, kundrejt çmimit të përcaktuar më poshtë.

CMIMI I SHITJES: 34 000 lekë (tridhjetë e katër mijë lekë).

Kjo vleftë i është paguar nga ana e blerëses, përfaqësuesit të pales shitëse z. Ledion Çala, para redaktimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës së Noterisë kesh në dorë, pa asnje lloj pretendimi nga palët.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ortakë të shoqërisë “INTEL MEDIA” shpk do të jenë:

- 1- Rexhep Himo, me 33 % të kuotave të kapitalit,
- 2- Shan Sulejmani, me 33 % të kuotave të kapitalit,

2
Teuta

3- Teuta Murati, me 34% të kuotave të kapitalit.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE:

Me nënshkrimin e këtij akti, shitësi Erjon Marini, humbet pronësinë e tij në kuotat e kapitalit të shoqërisë, duke mos pasur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e shitura, ndërsa blerësja Teuta Murati njihet pronare e ligjshme e këtyre kuotave.

Palët bien dakort që të gjitha të drejtat dhe detyrimet e derisotme që shoqëria "INTEL MEDIA" shpk, ka ndaj shtetit, bankave, subjekteve fizike/ juridike, ose të tretëve, cilatdo qofshin ato, do të përgjigjet shoqëria "INTEL MEDIA" shpk dhe tre ortakët : Rexhep Himo, Shan Sulejmani dhe Teuta Murati, sipas pjesës që i përket secilit në kapitalin e shoqërisë.

Për sa më sipër do të bëhen ndryshimet përkatëse në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit të Bizneseve.

Ky akt pasi lexohet nga palët dhe gjendet prej tyre në përputhje me vullnetin e tyre të lire, nënshkruhet në tre kopje origjinale me vlerë të barabartë.

Në zbatim të ligjit 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", (i ndryshuar) unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyre të drejtë dhe të ligjshme.

Unë noterja e vërtetoj aktin në përputhje me ligjin 110 datë 20/12/2018 "Për Noterinë".

P A L Ë T

PALA SHITËSE

ERJON MARINI
Përfaqësuar me prokurë prej
LEDION ÇALA

Ledion Çala

[Signature]

PALA BLERËSE

TEUTA MURATI

Teuta Murati

Murati

[Signature]

V E N D I M

Date 25/11/2019

I ASAMBLESE SE JASHTZAKONSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE "INTEL MEDIA" shpk

I marre ne Fier sot me daten 25/11/2019 ne seline e shoqerise "INTEL MEDIA" shpk, nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise:

1-REXHEP HIMO, i pranishem,

2-SHAN SULEJMANI, i pranishem,

3-ERJON MARINI, perfaqesuar me prokure prej LEDION ÇALA (sipas prokures se posacme te vertetuar nga Noteri ne Gjermani date 11/11/2019 dhe te vertetuar me Vule Apostille)

Duke pare ecurine e derisotme te veprimtarise se shoqerise, :

U KONSTATUA :

Shoqeria "INTEL MEDIA" SHPK, me qender ne Fier, me status Aktiv, eshte rregjistruar ne rregjistrin tregtar te shoqerive tregtare si person juridik, me numer NIPT K82803409T, me objekt veprimtarie "Veprimtari radiotelevizive", me ortake Rexhep Himo me 33% te kuotave te kapitalit, Shan Sulejmani me 33% te kuotave te kapitalit dhe Erjon Marini me 34% te kuotave te kapitalit.

Duke vleresuar ecurine e derisotme te shoqerise dhe duke pare kerkesat dhe interesat personale, ortaku Erjon Marini, kerkon te largohet nga shoqeria, duke ia shitur te gjitha kuotat e kapitalit zj. TEUTA MURATI, veprim i cili do te kryhet me akt noterial. Ne perfundim, Asambleja e Ortakeve,

V E N D O S I :

1-Miratimin per kalimin e nje pjese te kuotave te kapitalit te shoqerise "INTEL MEDIA" shpk, ne masen 34 %, nepermjet shitblerjes nga shitesi ERJON MARINI, tek bleresja TEUTA MURATI.

2- Caktimin e z. HAMZA HIMO, ne detyren e administratorit te shoqerise per nje periudhe pese vjecare me te drejte rizgjedhje.

3-Te ngarkohet z ILIR NATHANAILI per te kryer ndryshimet perkatese ne rregjistrin tregtar prane Qendres se rregjistrimit te bizneseve.



ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Rexhep HIMO

Shan SULEJMANI

Erjon MARINI

Perfaqesuar me prokure nga
LEDION ÇALA



PROKURE TEK NOTERI NE GJERMANI

me te cilen ERJON MARINI (personi qe ndodhet ne Gjermani) autorizon Z.LEDION ÇALA, te cilit i jep te drejte qe te paraqitet prane cdo zyre Noterie ne Shqiperi per te kryer veprimet e meposhtme:

Une i perfaqesuari **jam ortak ne shoqerine "TEEB CENTER" SHPK**, me qender ne Fier, me numer NIPT K43219401P dhe kam ne pronesi 33 perqind (ose 33 kuota) ne kuotat e kapitalit te kesaj shoqerie. Gjithashtu **jam edhe ortak ne shoqerine "INTEL MEDIA" SHPK**, me qender ne Fier, me numer NIPT K82803409T dhe kam ne pronesi 34 perqind (ose 34 kuota) ne kuotat e kapitalit te kesaj shoqerie.

Me anen e kesaj prokure, une emeroj perfaqesues te posacem z. LEDION ÇALA, i datelindjes 24/10/1982, lindur ne Fier dhe banues ne Fier, mbajtes i leternjoftimit ID numer I21024067A te cilit i jap te drejte qe te paraqitet ne cdo zyre noterie ne Republiken e Shqiperise, per te nenshkruar cdo lloj akti noterial per tjetersimin e kuotave te kapitalit qe mua me perkasin ne keto dy shoqeri, duke i dhene te drejte qe te tjetersoje keto kuota ne favor te vet ne cdo forme te lejuar nga ligji nepermjet dhurimit ose shitjes dhe **te beje kalimin e ketyre kuotave ne favorin e vete perfaqesuesit tim**, te caktoje cdo kusht te kontrates se tjetersimit te kuotave duke marre ai persiper (si perfituesi i kuotave te mia te kapitalit) cdo lloj te drejte dhe detyrimi qe une kam deri me sot si ortak ne keto 2 shoqeri, te caktoje cmimin e shitjes, te terheqe cmimin e shitjes, te administroje kuotat e mia, te nenshkruaje ne cdo lloj vendimi te Asamblese se Ortakeve qe lidhet me / administrimin e kuotave te kapitalit ose zhvillimin e aktivitetit te dy shoqerive si me siper, duke e caktuar ate si perfaqesues fuqiplote per te vendosur per cfaredo problem qe lidhet me kuotat e mia te kapitalit qe me perkasin ne keto 2 shoqeri, pa asnje kufizim dhe pa asnje perjashtim.

Per kete qellim perfaqesuesi im ka te drejte qe te vendose per cdo kusht te kontratave noteriale per sa u tha me siper, pa asnje lloj kufizimi, si edhe te kryeje cdo veprim tjetet dhe te nenshkruaje cdo akt, qe nuk eshte permendur ne kete prokure, por qe do te jete i nevojshem deri ne perfundim te veprimeve per te cilat ai eshte autorizuar.

KUJDES!

FIRMA E NOTERIT GJERMAN DUHET TE VERTETOHET ME VULE' APOSTILLE NE LANDIN PERKATES, NDRYSHE PROKURA ESHT E PAVLEFSHME.

ERJON MARINI



11.11.2019

Nr. 532 der Urkunderolle für 2019

Die vorstehend vor mir vollzogenen Unterschrift von


**Herrn Erjon Marini, geb. am 01.07.1976,
wohnhafte Am Kiebitzberg 2, 27404 Gyhum
-ausgewiesen durch albanischen Reisepass -**

beglaubige ich hiermit.

Der Notar fragte nach einer Vorbefassung i.S. des § 3 Abs. 1 Nr. 7 BeurkG, die verneint wurde.

Der Notar hat den Inhalt der Urkunde nicht überprüft da ihm die Sprache der Urkunde nicht verständlich ist. Nach Angabe der Beteiligten handelt es sich um eine Firmenvollmacht.

Rotenburg, den 11.11.2019



Notar

Notarkostenberechnung gem. § 19 GNotKG

Geschäftswert: 5.000,00 €

KV 25100 Beglaubigung einer Unterschrift oder eines Handzeichens

20,00 €

KV 32014 Umsatzsteuer 19 %

3,80 €

23,80 €



Notar

Apostille

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Land: Bundesrepublik Deutschland
Diese öffentliche Urkunde
2. ist unterschrieben von Ralf Tybuski
3. in seiner ~~hier~~ Eigenschaft als Notar
4. sie ist versehen mit dem ~~Stempel/Siegel~~ des/der
Notars Ralf Tybuski in
Rotenburg (Wilmme)

Bestätigt

5. in Verden/Aller
6. am 15. Nov. 2019
7. durch den Präsidenten des Landgerichts
8. unter Nr. 910 a 826/2019
9. Siegel/Stempel


10. Unterschrift

In Vertretung

Singer
Singer



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË
ZYRA E NOTERISË FIER
Notere/ Arjana Dodi/
Nr. 1522 rep. Nr. 560 kol.



DEKLARATË NOTERIALE

Në Fier, sot më datën 25/11/2019, në Zyrën e Noterisë, ne Adresen: Lagje 'Konferenca e Pezeş', rruga 'Jakov Xoxa', para meje noteres Arjana Dodi, anëtare e Dhomes Kombetare te Notereve Dega Vendore Vlore, me license nr. 16 date 07/08/1994 dhe NIPT K32721431M, u paraqit personalisht:

DEKLARUESJA :

EDIOLA NIKOLLAQ MARINI, dl. 20/09/1983, lindur në Fier dhe banuese në Fier, identifikuar me leternjoftimin ID numer personal I35920078I, e afte per te kryer veprime juridike, e cila me vullnetin e saj te lire, ne baze te ligjit 110 date 20/12/2018 'Per Noterine' kerkoj redaktimin e deklarates noteriale si vijon:

"Bashkeshorti im Erjon MARINI, eshte ortak ne dy shoqeri me pergjegjesi te kufizuar:

- 1- 'INTEL MEDIA' shpk me NIPT K82803409T dhe
- 2- 'TEEB-CENTER' shpk me NIPT K43219401P.

Me vullnetin tim te lire, jam pelqimin tim te plote qe bashkeshorti im Erjon Marini, te tjetersoje ne cfaredo forme dhe menyre te lejuar nga ligji, te gjitha kuotat e tij te kapitalit qe i perkasin ne keto dy shoqeri, kalim pronesie i cili do te behet ne favor te zonjes TEUTA MURATI dhe nga ana ime nuk ka asnje lloj pretendimi lidhur me sa me sipër."

Ne zbatim te ligjit 9887 date 10.03.2008 'Per mbrojtjen e te dhenave Personalë', (I ndryshuar) une noterja deklaroj se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjekteve te kesaj deklarate, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

Deklarata pasi lexohet dhe gjendet e rregullt, nenshkruhet ne pranine time nga deklaruesja ne tre kopje origjinale me vlere te barabarte.

Une noterja e vertetoj rregullisht.--

DEKLARUESJA

Ediolla Marini

Notere
Arjana Dodi

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20191125124655467
Data e Rezultatit të Kërkimit: 25.11.2019
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 12:46:55PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-060-1063
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

INTEL MEDIA SH.P.K.



Eva Kamberi